

Udhëzime mbi kufizimet për financimin e individëve të lidhur me personat e ekspozuar politikisht

DokuFest ngjashëm me shumicën organizatave të shoqërisë civile në Kosovë është i regjistruar si OJQ. Vlerat tona kryesore janë ndërtuar mbi programimin dhe pavarësinë e rigrantimit.

Për qëllimin e kësaj thirrje, DokuFest nuk do të ndaj fonde për Personat e Ekspozuar Politikisht

Person i ekspozuar politikisht do të thotë çdo person fizik vendas ose i huaj, të cilit i është ose u janë besuar poste të larta publike, si:

- 1) President/e, Kryeministër/e, ministër/e, zëvendësministër/e, këshilltar/e politik/e, shef/e i/e kabinetit;
- 2) Deputetë të Kuvendit;
- 3) Anëtarë/e të organeve drejtuese/qeverisëse të partive politike, në nivel qendror ose lokal;
- 4) Anëtarë/e të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës Supreme;
- 5) Ambasadorë/e ose të ngarkuar me punë në përfaqësim të shtetit ose zyrtarë të lartë ushtarakë;
- 6) Kryetarë/e komunash, nënkryetarë/e komunash, drejtorë/e komunalë, këshilltarë/e politikë të kryetarëve dhe nënkryetarëve, shefa/e të kabinetit të kryetarëve dhe nënkryetarëve;
- 7) Anëtarë/e të listës së partive politike që garojnë në zgjedhjet lokale ose nacionale;
- 8) Anëtarë/e të kuvendeve komunale.

Deklaratë mbi mos përfshirjen e personave të ekspozuar politikisht

Regjisori

Producenti